



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. 16 Prot.

Tiranë më 22.6.2018

PROCESVERBAL

Mbledhje e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Më datë 22 qershor 2018, ora 11:00, pranë ambjenteve të Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD), në Kryeministri nisi mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), e hapur për mediat dhe me të ftuar nga organizata të shoqërisë civile.

Të pranishëm janë:

Për përfaqësuesit e institucioneve publike:

1. Znj. Ogerta Manastirliu – *Kryetare e KKShC-së*
2. Znj. Merita Xhafaj
3. Z. Fran Brahimi
4. Znj. Alma Baze
5. Znj. Albana Merja
6. Znj. Oriana Arapi

Për përfaqësuesit e shoqërisë civile të KKShC-së:

1. Z. Blendi Dibra – *Zëvendëskryetar i KKShC-së*
2. Z. Vladimir Thano
3. Znj. Emanuela Zaimi
4. Znj. Arta Dyrmishi
5. Z. Ergys Gezka
6. Z. Ali Coka
7. Znj. Afërdita Seiti
8. Z. Altin Hazizaj

Përfaqësues nga AMShC:

1. Z. Andi Kananaj
2. Z. Erion Banushi
3. Znj. Mimoza Çorbaxhi
4. Z. Andi Luga

Mbledhja drejtohet nga Kryetarja e KKShC-së, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu, e cila falënderon të pranishmit për pjesëmarrjen dhe shton se nga verifikimi që bëme kemi kuorumin e nevojshëm për të filluar mbledhjen e Këshillit.

Me tej Kryetarja vazhdon me prezantimin e rendit të ditës:

1. *Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) të mbajtur më datë 6 mars 2018*
2. *Prezantimi i procesit për rishikimin e Udhërrëfyesit*
3. *Prezantimi dhe miratimi i përmbajtjes së Udhërrëfyesit*
4. *Prezantimi i pesë emrave më të votuar online nga anëtarët e KKSHC-së të zgjedhur anëtarë nga shoqëria civile për Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF)*
5. *Prezantimi dhe miratimi i Deklaratës së KKSHC-së në mbështetje të SDG-ve*
6. *Prezantim i punës së bërë nga komitetet e ngritura brenda Këshillit*
7. *Miratimi i datës për mbledhjen e ardhshme të KKSHC-së*

Edhe një herë znj. Ogerta falënderon të ftuarit dhe anëtarët e KKShC-së dhe në fjalën e saj thekson se që nga mbledhja e kaluar e deri më sot ka qenë një periudhë pune intensive dhe dialogu i bërë midis përfaqësuesve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), strukturave të qeverisë dhe gjithë aktorëve të interesuar për rishikimin e Udhërrëfyesit, për krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile.

Rishikimi i Udhërrëfyesit është bërë me asistencën e ekspertëve të BE-së dhe nëpërmjet procesit të dialogut me shoqërinë civile, i cili është iniciuar nga ekipi i Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes të Këshillit të Ministrave si dhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Më tej Ministria i përgëzon për punën e mirë që kanë bërë dhe i siguron se ky rishikim, me ekspertizën evropiane është bërë duke ndjekur parimet bazë si parimi i zhvillimit, parimi i transparencës dhe i konsultimeve që ka qenë në themel të këtij procesi. Gjithashtu, konsultimi i Raportit vullnetar të Shqipërisë për objektivat e një zhvillimi të qëndrueshëm në Axfordën e vitit 2030, është një raport i cili është miratuar në mbledhjen e Komitetit Ndërmintor i miratuar në mbledhjen e qershorit, i cili është shprehje e vullnetit politik për një bashkëpunim midis institucioneve shtetërore dhe sektorit të shoqërisë civile.

Po ashtu Kryetarja bën dhe një vlerësim për kontributin e të gjithë OJF-ve për nismat, iniciativat, por dhe strukturat ku është përfshirë shoqërinë civile. Falënderon përfaqësuesit e shoqërisë civile për konsultimin dhe shqyrtimin e akteve ligjore, shumë të rëndësishme për sot, derivate të ligjeve për shërbimet shoqërore, gjithashtu dhe sa i përket konsultimeve të raporteve për 2017 për pakicat në veçanti për komunitetin egjiptian, për raportin për barazinë gjinore, Këshillin Kombëtar për Barazinë Gjinore, dhe në lidhje me të gjitha ato plane pune në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të komunitetit LGBTI në kuadër të të drejtave të njeriut etj.

Gjate fjalës së saj, znj. Ogerta theksoi se ky Këshill ka treguar një vullnet dhe ka bërë një proces të mirë pune edhe në lidhje me zgjedhjen e pesë anëtareve për Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF), ku sugjeroi që menjëherë pas zgjedhjes së tyre, të bëhet hartimi i një metodologjie, mbi mënyrën e përzgjedhjes së fëmijëve që do të jenë pjesë e këtij Këshilli, në mënyrë që pa humbur kohë të mblidhet ky Këshill dhe të jetë sa më koherent me obligimet që rrjedhin nga axhenda kombëtare.

Më pas Kryetarja ftoi anëtarët e KKShC-së të miratonin pikën e parë, “Miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar” duke e hedhur në votim, të cilët e miratuan unanimisht.

Mbledhja vazhdon me pikën e dytë “Prezantimi i procesit për rishikimin e Udhërrëfyesit”.

Fjalën për pikën e dytë e merr znj. Valbona Petoshati, punonjëse në Departamentin e Zhvillimit dhe Mirëqeverisje në Kryeministri. Ajo thekson se ky Departament është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e punës për rishikimin e Udhërrëfyesit dhe për raportimin e tij.

Znj. Valbona vazhdon me prezantimin e hapave që janë ndjekur, nevoja pse duhej bërë ky rishikim, pengesat e hasura, mbështetja e kapaciteteve të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), metodologjia e ndjekur etj. Flet për aktivitetet e organizuar si dhe për çfarë mbetet për t’u bërë në vijim. Gjithashtu, ajo thekson: “Gjatë rishikimit të Udhërrëfyesit ne jemi asistuar edhe nga ekspertë të BE-së dhe se KKShC-ja dhe AMShC-ja do jenë aktorët kryesorë për ndjekjen e zbatimit të Udhërrëfyesit.”

Më pas Kryetarja e KKShC-së propozon që të kalohet në pikën e tretë, me prezantimin e përmbajtjes së Udhërrëfyesit të rishikuar dhe më pas me komentet nga të pranishmit.

Vijohet me prezantimin e Udhërrëfyesit nga znj. Merita Xhafaj, e cila thekson rëndësinë që ka ky dokument për zhvillimin e shoqërisë civile. Më tej ajo vazhdon me të gjitha prioritetet, gjithsej 9, të këtij dokumenti dhe vë theksin të aktorët për realizimin e tij, fushat kryesore, kuadrin ligjor dhe fiskal etj; hapat që do të ndiqen. Gjithashtu ajo thekson se do të ketë konsultime si dhe një konferencë tjetër deri në finalizimin e tij. Ajo shprehet: “Janë reflektuar të gjitha komentet dhe sugjerimet e bëra nga aktorë të shoqërisë civile. Nëse ka komente të tjera jemi të hapur. Dokumenti ju është vënë në dispozicion që më parë, prandaj kërkojmë nga KKShC që të shprehë dakordësinë dhe të miratojë këtë Udhërrëfyes.”

Kryetarja pyet nëse ka ndonjë koment për Udhërrëfyesin e rishikuar dhe se a janë dakord që Udhërrëfyesi është konsultuar dhe ka kaluar të gjitha etapat dhe hapat për të rakorduar çdo gjë.

Z. Altin Hazizaj ndërhyr për të bërë një sqarim: “Ne si KKShC nuk kemi listat e OJF-ve. Sekretariati që është AMShC-ja i ka këto lista, prandaj propozoj të ketë një koordinim me ne

në prezantimin e këtij dokumenti për OJF-të, pra nëse AMShC mendon ta ndajë me listat e veta dhe ne ta ndajmë me listat tona, të ftojme sa më shumë OJF për komente dhe sugjerime rreth këtij dokumenti.

Znj. Oriana Arapi, përfaqësuesja e Kryeministrit thekson: “Ky dokument është i publikuar te faqja “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” të Qeverisë dhe kjo faqe është e aksesueshme nga të gjithë, prandaj jeni të lutur të dërgoni sugjerimet tuaja deri më datë 20 korrik 2018. Komentet janë transparente, mund t’i shikoni online. Pra është edhe kjo mundësi. Ajo është në monitorim të vazhdueshëm dhe nga BE.”

Z. Ali Coka shprehet: “Për të nxitur aktivitetin e KKShC-së do të shtoja pjesën anabolike brenda kësaj konference. Nuk është turp që ta kërkojmë këtë gjë, dëshiroj që të diskutohet dhe shpjegohet ky dokument pasi jo të gjitha OJF-të kuptojnë çdo gjë, madje dhe ligjin ndonjëherë nuk e kuptojnë mirë. Ajo pjesë e vogël që është dedikuar për ne të shpërndahet te antarësia e KKShC-së dhe të jeni të bindur që nuk do ta keqpërdorim.”

Z. Vladimir Thanu shton: “Unë kam qenë pjesë e një konsultimi të gjerë rreth këtij dokumenti. Në takime dhe tryeza ne kemi përcjellë zërin e shoqërisë civile, por duke patur parasysh dhe progres raportin e BE-së për rëndësinë e këtij dokumenti, ku thuhet se pjesëmarrja e shoqërisë civile është okazionale, duke e konsideruar shoqërinë civile si aktor të rëndësishëm në këtë proces, dhe duke patur parasysh kohën kur ka ardhur, propozoj të miratohet në parim.”

Kalohet në proces votimi dhe të gjithë miratojnë përmbajtjen e Udhërrëfyesit.

Kalohet në pikën e katërt. Kryetarja prezanton pesë emrat më të votuar për anëtarë nga shoqëria civile për Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të cilët u zgjodhën nga një votim online i vendosur me konsensus.

Znj. Ogerta duke iu referuar Procesverbalit Nr. 10/2 Prot., datë 4.6.2018 të KKShC-së “*VOTIMI ONLINE – Për zgjedhjen e Pesë Anëtarëve nga Shoqëria Civile për Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*” shprehet se në fazën e kandidimit u paraqitën 18 kandidatura. Por me tërheqjen nga konkurrimi të znj. Juelda Lamçe, votimi online u zhvillua për 17 kandidatë dhe kishin të drejtë vote të gjithë anëtarët e KKShC-së. Në fazën e votimit online morën pjesë 17 anëtarë nga KKShC, të paraqitur sipas listës. Në përfundim të procesit të numërimit të votave për zgjedhjen e 5 (pesë) anëtarëve nga shoqëria civile për Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF), kandidatët me më shumë vota janë:

- | | |
|-----------------------|------------------------|
| 1. Znj. Anila Meço | 11 (njëmbëdhjetë) vota |
| 2. Z. Mirgjit Vataj | 8 (tetë) vota |
| 3. Znj. Drita Avdyli | 7 (shtatë) vota |
| 4. Znj. Eljona Elmazi | 7 (shtatë) vota |
| 5. Znj. Raimonda Bozo | 7 (shtatë) vota |

Znj. Ogerta shprehet se kështu, me zgjedhjen e anëtarëve i hapim rrugë dhe mbledhjes së parë të KKDMF-së dhe i uron suksese anëtarëve të zgjedhur.

Z. Altin lidhur me procesverbalin për votimin online propozon të shtohet një paragraph, ku të thuhet se votimi është bërë online, të ketë të pasqyruara të gjitha etapat e ndjekura dhe të thuhet se u autorizua nga KKSHC-ja dhe u realizua nga AMShC-ja. Pra të rishikohet procesverbali dhe të behen ndryshimet e propozuara.

Kalohet te pika e pestë, “Prezantimi dhe miratimi i Deklaratës së KKSHC-së në mbështetje të SDG-ve”.

Zv/Kryetari i KKShC-së, z. Blendi Dibra bën një prezantim të Deklaratës së KKShC-së në mbështetje të SDG-ve të përgatitur nga anëtarë të shoqërisë civile të KKShC-së.

Z. Blendi shprehet: “Do theksoja kontributin e dhënë nga shoqëria civile në procesin e zhvillimit të vendit dhe antarësimit si dhe kontributin e dhënë në monitorimin e etapave të realizimit të objektivave. Unë besoj se kjo është dhe do të jetë një vlerë e shtuar për shoqërinë civile.”

Përfaqesuesja e Kryeministria, znj. Oriana shton se ka dhe një rezolutë të miratuar nga Parlamenti. Ajo shpjegon se kjo Deklaratë pasi të miratohet do të jetë pjesë e dosjes së Këshillit të Ministrave.

Z. Vladimir propozon që Deklarata të redaktohet.

Z. Altin thekson rëndësinë e kësaj Deklarate dhe shprehet: “Deklarata është e nevojshme, por teksti nuk i përgjigjet realitetit dhe problemeve që ne kemi. Sugjerimet e mia i kam bërë prezent me e-mail. Ka disa momente ku përdoret fjala “**duhet**”; nuk do të bie dakord pasi nëse themi “duhet” lind pyetja pse nuk e ka bërë shoqëria civile deri tani. Pra nënkuptohet se e ka pasur mbështetjen, por s’e ka bërë. Më duket se këtu anashkalohet Udhërrëfyesi (RoadMap), sepse aty përcaktohet roli i shoqërisë civile, detyrimet për secilin. P.sh. tek faqja e dytë, paragrafi i katërt thuhet: “*Në mënyrë të veçantë, OShC-të duhet të punojnë për t’i përmbledhur këto qëllime në katër fusha kryesore:*”, ndërsa rekomandimi im do të ishte se në këtë drejtim ne nxisim mbështetjen e OShC-ve që ato të punojnë në këto drejtime duke garantuar edhe mbështetjen që Qeveria, bashkitë dhe donatorët do të japin për realizimin e këtyre fushave.”

Më tej, z. Altin shprehet se te paragrafi në vazhdim, i pesti, përmendet një iniciativë “*Leave no one behind*” dhe shprehet: “Mendoj se referenca te kjo s’duhet përdorur për aq kohë sa ne s’kemi një prezantim të kësaj nisme, ne duhet të mos e përmendim atë se mund të kemi një OJF tjetër, e cila të thotë se kam dhe unë këtë nismë etj., pra mund të kemi shumë nisma të tjera. Pra të eliminojmë të përveçmet. Kjo është një Deklaratë e KKShC-së për të cilën ne s’kemi informacion. Paragrafi 5-të dhe 6-të te faqja e dytë rekomandoj të eliminohet.

Ndërsa paragrafi në vazhdim, te paragrafi 7-të ku thuhet “... krijohen mundësi, hapësira dhe platforma ...” sugjeroj t’i hiqet fjala “dhe” dhe të shtohet fjala “programe, dhe platforma për për t’u angazhuar ...”

Një rekomandim i fundit i z. Altin është për krijimin e një Këshilli Konsultativ i OShC-ve të atashuar pranë Komitetit Ndërministror. Pra të mos ketë vetëm një anëtar, por çdokush i cili dëshiron të kontribuojë, ta ketë këtë të drejtë. Ky Këshill të krijojë raporte, *policy papers* etj. për të ndihmuar Këshillin e Ministrave. Ai mund të fuqizojë dhe punën e Komitetit dhe atë të Këshillit të Ministrave.

Z. Blendi shprehet: “Kjo është një Deklaratë e shoqërisë civile që shpreh angazhimin për t’u përfshirë në politikat e Qeverisë për zhvillimin ekonomik të vendit. Keni pasur kohë për të bërë një tekst alternativ. Kjo Deklaratë hap perspektivën për shoqërinë civile.”

Z. Ali ndërhyr dhe shprehet: “Për t’i dhënë vlerë Deklaratës ka anëtarë nga shoqëria civile të cilët kanë dhënë kontribute në kurrikulat për arsimin e mesëm profesional, në realizimin e objektivave për zhvillimit të qëndrueshëm. Këto objektiva përfshijnë zhvillimin e arsimit të mesëm profesional. Pra të futet arsimi të mesëm profesional.”

Znj. Oriana shton: “Edhe ne si Departament në Kryeministri kemi ndjekur procesin, në 30 maj është shprehur ideja dhe kjo është hedhur nga World Foundation. Një angazhim i shoqërisë civile për të shprehur vullnetin e saj. Ky është një angazhim global, një vullnet i 129 vendeve të tjera, secili vend do të përpiqet të angazhojë forcat për realizimin e objektivave. Axhenda e parë ishte vetëm për vendet në zhvillim. Nisma “*Leave no one behind*” është në kuadër të inkluzivitetit. Ndërsa programi i UN është diçka tjetër, ku janë përfshirë 4 organizata që veprojnë në shyllat e veta. Pra kjo Deklaratë është një angazhim i pastër i shoqërisë shqiptare, ku edhe shoqëria civile ka rolin e vet. Një rezolutë e tillë është miratuar nga Parlamenti në Dhjetor 2017. Po kështu dhe 20 universitetet kanë nënshkruar një Deklaratë në kuadër të SDG-ve. Pra forma e angazhimit ka vend për të gjithë. Mjetet për ta konsultuar mund t’i gjeni dhe sugjeroni dhe vetë përveç AMShC-së dhe aktorëve të tjerë. Ne si Qeveri mund të mbështesim dhe konsultimin me shoqërinë civile të kësaj Deklarate.”

Z. Altin sugjeron që përmbajtja duhet të reflektoje angazhimin e të gjithë shoqërisë civile, gjuha e përdorur duhet të jetë e duhura dhe të mos ketë referenca specifike. Ai shprehet: “Ajo që mendoj se vlen është se ne si shoqëri civile duhet të mbështesim një Deklaratë të tillë, por ajo të mos jetë e personalizuar dhe të vendosim referenca për ato që lidhen me punën tonë.”

Znj. Oriana thekson se është dakort me sugjerimet dhe se kjo Deklarate duhet të jetë pjesë e dosjes së Kryeministrit pasi është përmendur dhe në Raportin e Qeverisë, që do të prezantohet në New York, i cili është mbyllur dhe është deklaruar se do ketë një Deklaratë të tillë nga shoqëria civile. Ajo vazhdon më tej dhe shprehet: “Komiteti Ndërministror ka bërë tre mbledhje, kemi bërë vetëm një raport, pra kemi një udhëtim të gjatë për të bërë, pra kemi Këshillin si hallkën kryesore për mbarëvajtjen e këtij procesi. Një përfaqesues nga shoqëria

civile është propozuar nga Kryetarja dhe kjo është znj. Zana Vokopola, e cila e ka prezantuar këtë ide për Deklaratën në Komitetin Ndërmintor.”

Znj. Afërdita merr fjalën dhe shrehet: “Kjo Deklaratë, e cila është prezantuar nga znj. Zana, është propozuar nga ne, ka dhjetë ditë dhe ne të gjithë kemi qenë dakort. Altini ka pasur kohën e duhur për të bërë vërejtjet e tij, të pasqyroheshin dhe të kishim këtë Deklaratë sot. Sa për UN, unë kam qenë pjesë e këtyre tavolinave dhe çdo gjë është konsultuar me shoqërinë civile, i kemi ditur iniciativat si “*Leave no one behind*”, pra të miratohet Deklarata.”

Z. Ergys shprehet: “Dëshiroj të bëj një sugjerim për Zv./Kryetarin. Këto sugjerime të mos vijnë tani këtu, por të bëhen më përpara dhe këtu të sjellim produktin final. Takimet informale që bëjme duhet të vlejne edhe pse ne nuk marrim pjesë.”

Znj. Arta shton: “Jam dakort. I kemi konsultuar më parë, të kalohet në miratim.”

Z. Vladimir merr fjalën dhe thotë: “Lidhur me takimin e zhvilluar mes disa anëtarëve të shoqërisë civile të KKShC-së, të mbajtur më datë 30.5.2018. Unë di që mbledhja quhet formale sa kohë që ne mbledhemi, pra nëse futesh në një mbledhje duhet quajtur formale. Ne kemi djeni, se na i ka prezantuar Zana si anëtare zëvendësuese në Komitetin përkatës dhe për sa kohë kemi rënë dakord që të këtë një relativitet në lidhje me punën e anëtarëve të asocuar në Komitete të ndryshme, unë e quaj një seancë dëgjimi të vlefshme. Përsa i përket Deklaratës, Sekretariati të na kish sjellë sugjerimet e Altinit. Mendoj se Deklarata duhet të miratohet në parim, duke rikonsideruar dy paragrafë. Mendoj se iniciativa e “*Leave no one behind*” nuk duhet të hiqet pasi edhe siç e theksoi znj. Arapi, ajo është një instrument, është e rëndësishme që të jemi një zë dhe të mbështesim bashkëpunimin e krijuar në këtë Këshill midis të gjitha palëve, por duhet të mbështesim procesin dhe të miratojmë Deklaratën në parim.”

Drejtori Ekzekutiv i AMShC-së, z. Andi Kananaj shprehet: “Unë mendoj se që të na e bëni punën më të lehtë të zgjidhni:

1. Të kaloni e miratoni Deklaratën paragraf për paragraf, që të vendosim cilat janë ndryshimet;
ose
2. Të miratoni në parim Deklaratën dhe pastaj bëjmë ndryshimet, ku të thuhet që ky është dhe të vazhdojmë më printimet”

Kryetarja e KKShC-së dhe të gjithë anëtarët e pranishëm bien dakord me opsionin e dytë të paraqitur nga z. Andi Kananaj, që Deklaratën ta miratojnë në parim.

Më pas u vijua me pikën e gjashtë “Prezantim i punës së bërë nga komitetet e ngritura brenda Këshillit”.

Z. Vladimir shprehet: “Komitetet të mirëfunksionojnë, do isha dakord që dhe kolegët e Qeverisë të ishin këtu dhe të diskutoja.”

Z. Altin ndërhyt dhe thotë: “Kemi krijuar tri komitete dhe mendoj se kemi bërë një punë të mirë për Ligjin e financimit të OJF-ve.”

Znj. Ogerta pyet se kush do e çojë Ligjin për miratim. Më tej thotë: “Duhet të ketë një studim më të thelluar se ky Ligj do të prekë të gjithë sektorët, prandaj duhet parë se kush do të marrë leadershipin. Nëse nuk ka diçka tjetër të diskutojmë datën e takimit të ardhshëm. Është mirë që të kemi paraprakisht një datë.”

Kryetarja së bashku me anëtarët e tjerë ranë dakord në parim që në muajin Tetor të ketë një datë për takimin e radhës.

Në orën 12:15 mbledhja mbyllet.

SHTOJCA 1:

DRAFT – DEKLARATË

Mbi objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në kuadër të Axfordës 2030 të Kombeve të Bashkuara

SHTOJCA 1/1:

DRAFT – DECLARATION

On United Nations 2030 Agenda for Sustainable Development Goals

Mbajti procesverbalin:

Znj. Ina Gjini

Zv/Kryetar i KKSHC

Z. Blendi Dibra



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Tiranë më ____ . ____ . _____

DEKLARATË
MBI
OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM
NË KUADËR TË AXHENDËS 2030 TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), të cilat hynë në fuqi në janar 2016, janë një grup i ri universal i synimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore që shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara pritet të arrijnë deri në vitin 2030.

SDG-të edhe pse nuk janë ligjërisht të detyrueshme, përfaqësojnë një angazhim politik mbi zhvillimin nga të gjitha vendet anëtare të OKB-së. Këto qëllime universale pritet të krijojnë një pikë referimi që siguron balancimin e zhvillimit ekonomik dhe qëllimeve globale mjedisore me objektivat e reduktimit të varfërisë.

Shqipëria i është bashkuar Partneritetit Global, i projektuar për të dhënë një kontribut të fuqishëm në arritjen e Agjendës 2030 dhe mbetet plotësisht e angazhuar për zbatimin e Axhendës 2030 në kontekstin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe procesin e Integritimit Evropian.

Deri më sot, diskutimet mbi SDG-të kanë qenë të lidhura kryesisht me përcaktimin e qëllimeve dhe treguesve. Më pak vëmendje i është kushtuar diskutimit të roleve dhe përgjegjësisë që duhet të marrin aktorët e ndryshëm në arritjen e këtyre qëllimeve në veçanti dhe se si ta zbatojnë në formën më të mirë në nivel qendror e lokal këtë kornizë universale.

Duke pasur parasysh qëllimin dhe ambicien e SDG-ve, është e qartë se qeveria e vetme nuk mund t'i arrijë e përmbushë këto qëllime. Qeveria duhet të lehtësojë e mundësojë pjesëmarrjen e të gjithë sektorëve të shoqërisë, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile (OShC), sektorin privat dhe publikun e gjerë.

Përfshirja e OShC-ve në këto procese është bërë e domosdoshme, sepse ato luajnë rol vendimtar në shoqëri si agjentë të llogaridhënies dhe ofrimit të shërbimeve.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile e konsideron hyrjen në Bashkimin Evropian si prioritet kryesor dhe ambicien më të rëndësishme strategjike të vendit, pasi procesi i

integritit në BE mbart konsensus të plotë politik dhe mbështetje mbarëkombëtare, duke u shndërruar në një mënyrë solide për të arritur një të ardhme të qëndrueshme për qytetarët e Shqipërisë.

Këshilli vlerëson përpjekjet e ndërmarra për të lidhur SDG-të me objektivat e integritit në BE, duke iu referuar Strategjisë Kombëtare për Integrimin Evropian 2014-2020 dhe kapitujve të Acquis të BE-së që çojnë vendin drejt perspektivës evropiane.

Në këtë proces, shoqëria civile duhet të luajë një rol kritik në nxitjen e avokimit dhe ndërmjetësimin në zhvillimin e politikave, duke identifikuar prioritetet kryesore të zhvillimit, duke propozuar zgjidhje praktike dhe mundësi politike dhe duke kritikuar ato politika jopraktike ose problematike.

Në mënyrë të veçantë, OShC-të duhet të punojnë për t'i përmbledhur këto qëllime në katër fusha kryesore:

1. duke u dhënë një zë qytetarëve më të varfër dhe më të marginalizuar,
2. duke shërbyer si agjentë të llogaridhënies,
3. duke vepruar si ofrues shërbimesh dhe
4. duke monitoruar zhvillimin përmes mbledhjes së të dhënave dhe raportimit.

Një vëmendje të veçantë merr për ne iniciativa që paraprin objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm: *“Leave no one behind”* - *“Askush i braktisur”*, që reflekton ambicjen për një proces gjithëpërfshirës, ku qeveria hyn në partneritet me të gjithë sektorët e shoqërisë e ku *“Agenda 2030”* e thekson qartë rolin e shoqërisë civile për të përfshirë në këtë iniciativë të gjithë grupet e interesit, por kryesisht ata në nevojë.

Këtë domosdoshmëri të shprehur e miratojnë edhe anëtarët, bashkë me votuesit e tyre, pra mbi 1000 organizata të shoqërisë civile, që vlerësojnë nevojën dhe shprehen të gatshëm për t'u përfshirë në proceset e monitorimit. Kjo kërkon që OShC-të të jenë proaktive në mbledhjen e informacionit dhe bashkëveprimin me komunitetet.

Për këtë arsye, është e rëndësishme të krijohen mundësi, hapësira dhe platforma për t'u angazhuar në mënyrë që të promovohen dialogjet e vërteta, të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit dhe të zhvillohen marrëdhënie të forta.

SDG-të përbëjnë një referencë globalisht legjitime për OShC-të, të cilat mund të propozojnë futjen e shumë çështjeve në rrafshin e hartimit të politikave. Aty ku është e mundur, OShC-të duhet të identifikojnë përmirësime ose ndërhyrje që mund të sjellin një ndryshim të rëndësishëm për njerëzit në nevojë. Fokus sërish, duhet të marrë përktimi i zërit të qytetarëve më të varfër dhe më të marginalizuar në argumente racionale e të forta që të njihen dhe adresohen nga pushteti qendror dhe lokal.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile vlerëson si të rëndësishëm zhvillimin e marrëdhënieve dhe partneritetit me qeverinë qendrore dhe lokale, dhe në veçanti,

identifikimin e strukturave të qeverisë, aktorëve apo institucioneve përgjegjëse për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që has shoqëria.

Shoqëria civile duhet të luajë rolin kritik të transformatorit në shoqërinë shqiptare duke u përfshirë në proceset e trajnimit dhe advokimit, të cilat mundësojnë ngritjen e kapaciteteve dhe njohurive të popullatës së përgjithshme në procesin e arritjes së SDG-ve.

Në linjë me zbatimin e SDG-ve, mbledhja e të dhënave, raportimi dhe monitorimi duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës dhe transparent që përfshin ekspertë statistikorë, OSHC-të, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, ofruesit e shërbimeve dhe pjesët e marginalizuara të shoqërisë sonë.

Në këtë proces, përtej kontributit dhe ekspertizës së mbledhjes së të dhënave, OShC-të gjithashtu duhet të kenë një rol të rëndësishëm në monitorimin e drejtpërdrejtë të zbatimit të SDG-ve.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile e vlerëson si thelbësore elaborimin e rolit të sektorit të shoqërisë civile në zbatimin efektiv të SDG-ve si dhe domosdoshmërinë për rritjen e angazhimit, ndikimit dhe efektivitetit i të saj në proceset e zhvillimit të vendit. Në këtë kuadër, Këshilli, konfirmon gatishmërinë, angazhimin dhe vullnetin e palëkundur për të ofruar dhe mundësuar asistencën e organizatave të shoqërisë civile përgjatë të gjithë procesit të përmbushjes së SDG-ve përmes njohurive dhe eksperiencave sipas fushave që ky Këshill mbulon.



REPUBLIC OF ALBANIA
NATIONAL COUNCIL FOR CIVIL SOCIETY

Tirana, ____ . ____ . ____

**DECLARATION
ON
UNITED NATIONS 2030 AGENDA
FOR SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS**

The Sustainable Development Goals (SDGs), which entered into force in January 2016, are a new universal set of economic, social and environmental goals that United Nations member states are expected to reach by 2030.

SDGs, though not legally binding, represent a political commitment to development, by all UN member states. These universal goals are expected to create a benchmark that ensures the balance of economic development and global environmental goals with poverty reduction targets.

Albania has joined the Global Partnership, designed to make a strong contribution to achieving the Agenda 2030 and remains fully committed to implement the 2030 Agenda in the context of the National Strategy for Development and Integration as well as the European Integration Process.

Up to now, discussions on SDGs have been mainly linked to the definition of goals and indicators. Less attention has been paid to the discussion on the roles and responsibilities that different actors must take over, to achieve these goals, particularly, and how best to apply this universal framework at central and local level. Given the purpose and ambition of SDGs, it is clear that the Government itself could not achieve these goals. The Government should facilitate and enable the participation of all sectors of society, including civil society organizations (CSOs), the private sector and the general public.

The involvement of CSOs, in these processes, becomes necessary because they play a crucial role in society, as the agents of accountability and service delivery.

The National Council for Civil Society considers the accession into the European Union as a top priority and the country's most important strategic ambition, as the EU integration process bears full political consensus and nationwide support, turning it into a solid way to reach a sustainable future for the citizens of Albania.

The Council appreciates the efforts undertaken to link SDGs with EU integration goals, referring to the National Strategy for European Integration 2014-2020 and the EU Acquis Chapters, which lead the country to the European perspective.

In this process, the civil society should play a critical role in promoting advocacy and mediation regarding policy development, by identifying key development priorities, by proposing practical solutions and policy options, as well as by criticizing those impractical or problematic policies.

Particularly, CSOs should work to summarize these goals in four key areas:

1. *giving voice to the poorest and most marginalized citizens,*
2. *servicing as accountability agents,*
3. *acting as service providers and*
4. *monitoring development through data collection and reporting.*

Special attention is given to initiatives that precede the Sustainable Development Goal: “*Leave no one behind*”, which reflects the ambition for an all-inclusive process, whereby the Government enters into partnership with all sectors of the society, and where “The Agenda 2030” clearly emphasizes the role of civil society to involve all stakeholders, but mainly those in need, in this initiative.

This stated necessity is approved by the members, too, together with their voters, so over 1000 civil society organizations, who appreciate the need have expressed their readiness to be involved in the monitoring processes. This requires that CSOs be proactive in gathering information and interacting with communities.

For this reason, it is important to create opportunities, spaces and platforms to be engaged, in order to promote true dialogues, increase community awareness and develop strong relationships.

For this reason, it is important to create opportunities, spaces and platforms to be engaged, in order to promote true dialogues, increase community awareness and develop strong relationships.

SDGs are a globally legitimate reference for CSOs, which may propose the introduction of many issues in policy-making framework. Where it is possible, CSOs need to identify improvements or interventions which can bring about a significant change for people in need. The focus should, again, be on translating the voice of the poorest and most marginalized citizens into rational and strong arguments, to be recognized and addressed by the central and local government.

The National Council for Civil Society values, as very important, the development of the relationships and partnerships with central and local government, and particularly, the

identification of the government structures, actors or responsible institutions for the solution of various problems, faced by society.

Civil society should play the crucial role of transformer in the Albanian society by being engaged in training and advocacy processes, which enable capacity and knowledge building for the general population in the process of SDGs achieving.

In line with SDGs implementation, data collection, reporting and monitoring should be a comprehensive and transparent process, involving statistical experts, CSOs, national human rights institutions, service providers and marginalized groups of our society.

In this process, beyond the contribution and expertise of data collection, CSOs should also play an important role in direct monitoring of the implementation of SDGs.

The National Council for Civil Society considers essential the elaboration of the role of the civil society sector for the effective implementation of SDGs, as well as the necessity to increase its engagement, its impact and its effectiveness in the country's development processes. In this context, the Council confirms its readiness, commitment and unwavering willingness to provide and enable the assistance of civil society organizations throughout the process of meeting SDGs, through their knowledge and experiences according to areas covered by the Council.